

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende të lira për personel akademik të kategorisë Lektor me kohë të plotë pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës në Departamentin e Urbanistikës si më poshtë:

A. Kriteret e punësimit për një (1) vend pune për personel akademik efektiv, në kategorinë “Lektor”, për lëndët që janë zhvilluar nga staf akademik me kontratë, si më poshtë:

Programi i studimit	Lënda	Kredite	Ngarkesa totale (orë)
URB_viti IV_sem 1	Legjislacion arkitektonik e urban	3	51
ARK_viti IV_sem 2	Legjislacion	3	68
ARK_viti IV_sem 2	Urbanistikë 2 (seminare)	7	72
	Ngarkesa totale vjetore e parashikuar		191

B. Kriteret e punësimit për një (1) vend pune për personel akademik efektiv, në kategorinë “Lektor”, për lëndët që janë zhvilluar nga staf akademik me kontratë, si më poshtë:

Programi i studimit	Lënda	Kredite	Ngarkesa totale (orë)
URB_viti V_sem 1	Metoda kerkimore te aplikuar ne urbanistike	4	84
URB+ARK_viti III_sem 2	Urbanistikë 1 (seminare)	8	122
	Ngarkesa totale vjetore e parashikuar		206

Kandidatët për personel akademik efektiv, në kategorinë “Lektor”, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë Diplomë të nivelit Bachelor dhe Master Shkencor ose Master të Integruar Shkencor në Arkitekturë dhe Urbanistikë;
2. Të ketë notë mesatare të ponderuar për secilin cikël studimi apo të ciklit të integruar, së paku 85/100.
3. Të ketë fituar gradën shkencore ‘Doktor’ në Arkitekturë dhe Urbanistikë;
4. Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë profesionale dhe mësimdhënie në IAL;
5. Të zotërojë të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht.

Kriteret plotësuese si më poshtë:

1. Preferohet mesatarja së paku 9/10 për lëndët projektuese dhe teorike profesionale mbi Urbanistikën dhe Planifikimin Urban;
2. Preferohet të ketë eksperiencë mësimdhënie në lëndët e specifikuara;
3. Preferohet të ketë botuar artikuj shkencorë në fushat kërkimore që mbulon Departamenti.

II. Dokumentacioni që duhet të dorëzojë kandidati:

1. Letër motivimi / interesi me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimi i detajuar (CV) akademik dhe profesional;
3. Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
4. Kopje e diplomave universitare dhe listës së notave të noterizuara. Kopje të noterizuar të gradës shkencore me përmbledhje të temës së mbrojtur. Për diplomat dhe titujt e fituar jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njohja dhe njësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
5. Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (në të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton punësimin, trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë etj. (nëse ka), të noterizuara;
7. Dy publikime të plota të përzgjedhura (artikull, ese, punime shkencore etj.);
8. *Portfolio* punësh të lidhura me fushën e arkitekturës dhe urbanistikës dhe projekte kërkimore;
9. Letër reference nga dy persona me gradë ose titull akademik (referenca të paraqitet në zarf të mbyllur të firmosur nga referenti);
10. Dëshmi e gjuhës së huaj;
11. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
12. Vërtetim të gjendjes shëndetësore.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **28.02.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratit e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.